



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ për vitin 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen këto Projektligje:
 - 1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike (MTI);
 - 1.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë (MF);
 - 1.3. Projektligji për Transplantimin e Qelizave dhe Indeve (MSH), dhe
 - 1.4. Projektligji për Transplantimin e Organeve (MSH).

2. Ndryshohet afati për procedim në Qeveri i Projektligjeve si në vijim:
 - 2.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kinematografinë 30.09.2012 (MKRS);
 - 2.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Trashigiminë Kulturore të Kosovës 31.07.2012 (MKRS).

3. Nga Programi Legjislativ i vitit 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës hiqen:

- 3.1. Projektligji për Muzetë (MKRS), dhe
 - 3.2. Projektligji për Transplantimin të Qelizave, Indeve dhe Organeve (MSH).
4. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

 5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që Amendamentin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Vlerësimit të Komitetit Qeveritar të Privatizimit (KQP) të Kompanisë Kosovare të Distribucionit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KKDFE), për shpalljen e konsorciumit Calik - Limak si Ofertues i Preferuar.
2. Autorizohet KQP e KKDFE për procedim të mëtutjeshëm në procesin e privatizimit sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në "Kërkesën për Propozime" të pakos tenderuese në privatizimin e KKDFE.
3. Obligohet KQP e KKDFE për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Projektligjin për Dërgimin e Kontingjentit të FSK-së jashtë vendit.
2. Obligohet Ministria e Forcës së Sigurisë dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

**Për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërministror për zhvillimin e Projektit "Rruga 6"
(Autostrada Prishtinë-Hani i Elezit)**

1. Emërohet Komiteti Drejtues Ndërministror për zhvillimin e projektit "Rruga 6" (Autostrada Prishtinë - Hani i Elezit), në këtë përbërje:
 - 1.1 Ministri i Infrastrukturës – kryesues;
 - 1.2 Ministri i Financave – anëtar;
 - 1.3 Ministri i Tregtisë dhe Industrisë – anëtar;
 - 1.4 Ministri i Zhvillimit Ekonomik – anëtar;
 - 1.5 Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – anëtar.
2. Për marrjen e vendimeve nga Komiteti Drejtues Ndërministror kërkohet vota afirmative e shumicës së anëtarëve të Komitetit, duke përfshirë votën afirmative të Ministrit të Infrastrukturës dhe Ministrit të Financave.
3. Ministria e Infrastrukturës do të jetë autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit për shërbimet e këshilltarit të transaksionit.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Forcës së Sigurisë për dërgimin e 53 (pesëdhjetë e tre) pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë për pjesëmarrje në rastin e ceremonisë së 100 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë.
2. Obligohet Ministria e Forcës së Sigurisë për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për procedurat e blerjes dhe marrjes me qira të objektit për misione diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për etiketimin e pajisjeve që shfrytëzojnë energji.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 4 të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2013.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij Plani ta harmonizoj me Ligjin për Buxhetin e vitit 2013.
3. Obligohet Agjencioni i Statistikave të Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 19 (6.2) të Rregullores nr. 09/2012 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh Vendimin e Kryeministrit (nr. 062-12.08.2011) për emërimin e Koordinatorit për të drejtat pronësore, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

Për Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit për të Drejtat Pronësore

1. Koordinatori për të Drejtat Pronësore ka detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
 - 1.1. Këshillon Kryeministrin e Republikës së Kosovës në fushën e të drejtave pronësore;
 - 1.2. Do të njihet me aktivitetet e të gjitha institucioneve publike që kanë mundësi të ndikojnë në të drejtat pronësore në Kosovë;
 - 1.3. Koordinon hartimin e politikave për çështjet pronësore dhe aktivitetet në reformat e të drejtave pronësore;
 - 1.4. Bashkërendon shqyrtimin e legjislacionit nga të gjitha Ministritë dhe Agjencitë përkatëse i cili ndikon apo krijon të drejtat pronësore në Kosovë për të përcaktuar se cili legjislacion ofron mbrojtjen adekuate për të drejtat pronësore, përfshirë këtu edhe të drejtat e personave të zhvendosur dhe grupeve të rrezikuara siç parashihet nga standardet më të mira ndërkombëtare;
 - 1.5. Inicion debate dhe mundëson diskutimin me dhe në mes të degës së pushtetit ekzekutiv në Kosovë, degës së pushtetit ligjvënës në Kosovë, shoqërisë civile dhe aktorëve joqeveritarë ndërkombëtarë dhe kosovarë, të cilët janë të interesuar për mbrojtjen e të drejtave pronësore për të identifikuar shqetësimet që kanë të bëjnë me mungesën e mbrojtjes së të

drejtave pronësore në Kosovë, si dhe përgatit raportin për rezultatet e punës në këtë drejtim;

- 1.6. Bashkërendon përpilimin e politikave të bazuara në rezultatet e këtij vlerësimi dhe diskutimi publik, me anë të cilave duhet të mbrohen të drejtat pronësore, në veçanti të drejtat e personave të zhvendosur dhe grupeve të rrezikuara në Kosovë;
 - 1.7. I ofron këshilla për politikat Kryeministrit të Kosovës bazuar në rezultatet e dala nga këto procese të konsultimeve që i mundësojnë Qeverisë së Kosovës të propozojnë masa të cilat do të mbrojnë të drejtat pronësore në Kosovë;
 - 1.8. Në bazë të politikave të përcaktuara nga Kryeministri i Kosovës dhe në konsultim të plotë me Ministrinë dhe Agjencitë përkatëse, do të përgatisë një strategji dhe plan veprimi për mbrojtjen e të drejtave pronësore, në veçanti të drejtat e personave të zhvendosur dhe grupeve të rrezikuara në Kosovë, që do të nënkuptonte edhe një raportim gjithëpërfshirës dhe mekanizëm mbikëqyrës që do të sigurojnë dhe dëshmojnë realizimin e qëllimeve të identifikuar në strategji dhe plan të veprimit;
 - 1.9. Bashkërendon aktivitetet që zhvillohen nëpër Ministri dhe Agjenci në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit të Qeverisë për mbrojtjen e të drejtave pronësore, me qëllim që prioritetet e Qeverisë të reflektohen dhe të përfaqësohen në dokumentet vjetore operative të këtyre institucioneve, aranzhon shqyrtimin e rregullt të këtyre aktiviteteve për të siguruar që korniza legjislative për mbrojtjen e të drejtave pronësore të jetë efektive, dhe nëse kjo nuk ndodh, atëherë do të propozojë reformat e duhura pas konsultimeve përkatëse me të gjitha palët e interesit;
 - 1.10. Bashkërendon aktivitetet e Ministrisë dhe Agjencisë në zbatimin e strategjisë së Qeverisë dhe planit të veprimit për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të pyjeve. Aranzhon shqyrtimin e këtyre aktiviteteve për të siguruar që korniza legjislative për mbrojtjen e të drejtave pronësore të jetë efektive, dhe nëse kjo nuk ndodh, atëherë do të propozojë reforma pas konsultimeve përkatëse me të gjitha palët e interesit;
 - 1.11. Kryen detyra të tjera të caktuara nga Kryeministri i Kosovës, dhe të cilat kanë të bëjnë me strategjinë dhe planin e veprimit të qeverisë për mbrojtjen e të drejtave pronësore;
 - 1.12. Koordinatorin për të drejtat pronësore i përgjigjet direkt Kryeministrit apo Zëvendëskryeministrit të caktuar nga Kryeministri.
2. Obligohen të gjitha institucionet publike që të bashkëpunojnë me Koordinatorin për të Drejtat Pronësore dhe ti ofrojnë ndihmën e kërkuar.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02/67 të datës 21.03.2012

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi për themelimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës, i cili kryesohet nga Zëvendëskryeministrja për Ekonomi/Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Nr. 02/67 i datës 21.03.2012 në pikën 2 edhe me dy anëtarë tjerë, edhe atë:
 - 1.1 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - 1.2 Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/78
Datë: 12.06.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafi 2, dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 02/L-40 për Provimin e Jurisprudencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2012, mori:

V E N D I M


Për Plotësimin e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për anëtarë të Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës, propozon këta kandidatë:
 - 1.1 Dr. Sc. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën E drejta penale (materiale dhe procedurale);
 - 1.2 Adem Vokshi, Avokat, Anëtar i komisionit, pyetës për lëndën e Drejta Civile (materiale dhe procedurale) familjare, trashëgimore dhe detyrimore;
 - 1.3 Suzana Sejdiu, Kryetare e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Anëtar i komisionit, pyetës për lëndën E drejta Tregtare (ekonomike);
 - 1.4 Prof. Dr. Ivan Čukalovič, Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Anëtar i komisionit, pyetës për lëndën Parimet dhe struktura Kushtetuese dhe Organizimi i Gjyqësorit,
 - 1.5 Meleqe Bexheti, Gjyqtare në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, Anëtar i komisionit, pyetës për lëndën E drejta e Punës;
 - 1.6 Dr. Sc. Mirlinda Batalli, Profesoreshë, Anëtar i komisionit, pyetës për lëndën E drejta Administrative;

- 1.7 Prof. Dr. Asllan Bilalli, Profesor, Anëtar i komisionit, pyetës për lëndën E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
2. Për zëvendës të anëtarëve të komisionit, propozohen këta kandidatë:
- 2.1 Dr. Sc. Bajram Ukaj, Profesor, Zëvendës i Kryetarit të komisionit për lëndën E drejta penale (materiale dhe procedurale);
- 2.2 Dr. Sc. Haxhi Gashi, Ligjërues, Zëvendës i anëtarit të komisionit për lëndën e Drejta Civile (materiale dhe procedurale) familjare, trashëgimore dhe detyrimore;
- 2.3 Dr. Sc. Korab Sejdiu, Profesor, Zëvendës i anëtarit të komisionit për lëndën E drejta Tregtare (ekonomike);
- 2.4 Dr. Sc. Visar Morina, Profesor, Zëvendës i anëtarit të Komisionit për lëndën Parimet dhe struktura Kushtetuese dhe Organizimi i Gjyqësorit;
- 2.5 Mr. Sc. Rafet Haxha, gjykatës, Gjykata e Qarkut, Prishtinë, Zëvendës i anëtarit të komisionit për lëndën E drejta e Punës;
- 2.6 Nebojsa Boričić, Gjykatës në Gjykatën Supreme, Zëvendës i anëtarit të komisionit për lëndën E drejta Administrative, dhe
- 2.7 Dr. Sc. Qerim Qerimi, Profesor, Zëvendës i anëtarit të komisionit për lëndën E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për Sekretar të Komisionit, propozohet:

- 3.1 Elbasan Dervishaj, Sekretar i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që vendimin, së bashku me biografitë e kandidatëve, t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë